

**MEHMET PASHË DERALLA, MISIONAR NË MBROJTJE  
TË ÇËSHTJES KOMBËTARE  
Ola SHANO**

**UDK: 342.15:323.1(496.5)“18/19”**

**Abstrakt**

Gjatë gjithë procesit historik të ekzistencës së tyre, shqiptarëve nuk u është dashur të përballen vetëm me dukuritë natyrore, por mbi të gjitha me natyrën njerëzore dhe prirjen e vazhdueshme për asimilim.

Në lidhje me këtë aspekt të rëndësishëm dhe të kudondodhur në Historinë Kombëtare, studiuesit vendas dhe të huaj janë përpjekur të trajtojnë e të hedhin dritë mbi disa nga veçoritë kryesore të luftërave, mësymjeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme për pavarësi, integritet kulturor dhe territorial të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, në arenën e konflikteve ballkanike të shfaqura kohë pas kohe në forma dhe situata nga më të ndryshmet.

Duke e përqendruar objektin e trajtimit në suazën e zhvillimeve të fundit të shekullit XIX dhe fillimet e shekullit XX, mund të themi se roli i Mehmet Pashë Derallës në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve të mëdha të Kosovës të viteve 1910, 1911 dhe 1912 përbën një rëndësi jetike për këtë hark kohor, i cili me të drejtë vlerësohet si nga me vendimtarët në luftën dhe përpjekjet e vazhdueshme për pavarësi. Ishin këto beteja që kulmuan me atë të verës së vitit 1912, e cila shënoi marrjen e Shkupit, ish-qendrës së Vilajetit të Kosovës.

Kryengritësit shqiptarë tronditën tërë mjedisin ballkanik, në të cilin faktori shqiptar filloi të bëhej mbizotërues. Në fokusin e lëvizjes së tyre u vendos në këtë periudhë shpërfillja e hegjemonizmit të shteteve fqinje siç ishin, Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia, të cilat prej kohësh

konsolidonin strategjinë e tyre, që kishte të bënte me mohimin e ekzistencës së kombit shqiptar, në mënyrë që të zgjeronin territoret e tyre. Gjenerali Deralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë veriore. Nën komandën e tij, luftëtarët shqiptarë i gozhduan forcat serbe në hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë e Drinit të Zi. Në zanafillën e shtetit të ri shqiptar, me shpalljen e Pavarësisë Kombëtare më 28 Nëntor 1912, Kuvendi i mbledhur në Vlorë në të cilin merrnin pjesë të gjitha viset shqiptare, në detyrën e ministrit të Mbrojtjes të Qeverisë së kryesuar nga Ismail Qemali, u zgjodh Mehmet Pashë Deralla, i cili për vetë rolin dhe peshën që përfaqësonte aso kohe në këto zhvillime iu besua ky post nga më të rëndësishmit në atë kabinet qeverisës, për vijimësinë e shtetit të sapo formuar shqiptar.

**Fjalë kyçe:** histori kombëtare, Mehmet Pashë Deralla, beteja për pavarësi, kryengritësit shqiptarë.

## HYRJE

Gjatë gjithë procesit historik të ekzistencës së tyre, shqiptarëve nuk i është dashur të përballen vetëm dhe thjesht me dukuritë natyrore, por mbi të gjitha me natyrën njerëzore dhe prirjen e vazhdueshme për asimilim. “Politika e mohimit të identitetit nacional të shqiptarëve dhe klasifikimi i tij me përkatësinë religjioze, nga njëra anë, dhe hedhja poshtë e kërkesave të Shqipërisë për autonomi, nga ana tjetër, qe pjesë e politikës osmane nga vitet e 30-ta të shekullit XIX, kohë kur u lind Lëvizja Kombëtare Shqiptare”<sup>382</sup>.

Në lidhje me këtë aspekt të rëndësishëm në Historinë Kombëtare, studiuesit vendas dhe të huaj janë përpjekur të trajtojnë e të hedhin dritë

---

<sup>382</sup> Myzafer Bislimi: Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk, studim, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2008. f. 26.

mbi disa nga veçoritë kryesore të luftërave, mësymjeve dhe përpjekjeve të vazhdueshme për pavarësi dhe integritet kulturor dhe territorial të Shqipërisë dhe shqiptarëve në arenën e konflikteve ballkanike, të shfaqura kohë pas kohe në forma dhe situata nga më të ndryshmet. “Historia trevjeçare e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit me luftën që zhvilloi dhe udhëhoqi për ruajtjen e tërësisë së trojeve shqiptare dhe për krijimin e shtetit kombëtar shqiptar, qoftë edhe autonom, është mbushur plot ngjarje dhe data që flasin për zgjerimin dhe thellimin e luftës së popullit shqiptar në ato vite”<sup>383</sup>.

Duke e përqendruar objektin e trajtimit në suazën e zhvillimeve të fundit të shekullit XIX dhe fillimet e shekullit XX, mund të themi me bindje të plotë se roli i Mehmet Pashë Derallës në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve të mëdha të Kosovës të viteve 1910, 1911 dhe 1912 përbën një rëndësi jetike për këtë hark kohor, i cili me të drejtë vlerësohet si nga me vendimtarët në luftën dhe përpjekjet e vazhdueshme për pavarësi, në një kohë kur “Shqipëria po kalonte çastet më të vështira, duke pasur shumicën e territorit të saj të pushtuar nga trupat armike”<sup>384</sup>. Ishin pikërisht këto etapa me rëndësi historike që kulmuan me atë të verës së vitit 1912, e cila shënoi marrjen e Shkupit, ish - qendrës së Vilajetit të Kosovës. Në këtë periudhë të ngarkuar dhe të tensionuar zhvillimesh dhe përpjekjesh, kryengritësit shqiptarë, tronditën tërë mjedisin ballkanik, në të cilin faktori shqiptar filloi të bëhej mbizotërues.

Në fokusin e lëvizjes së tyre, u vendos në këtë periudhë shpërfillja e hegjemonizmit të shteteve fqinje siç ishin, Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia, të cilat prej kohësh konsolidonin strategjinë e tyre që kishte të bënte me mohimin e ekzistencës së kombit shqiptar, në mënyrë që të zgjeronin territoret e tyre. Gjatë këtyre zhvillimeve, gjenerali Deralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës

---

<sup>383</sup> Gazmend Shpuza: Në vazhdën e gjurmëve për epokën e Rilindjes Kombëtare, Sh.B. Toena, Tiranë 1997, f. 43.

<sup>384</sup> Edvin Jacques: Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, studim, Sh.B. Kartë e Pendë, Tiranë 1997, f. 357.

shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë veriore. Nën komandën e tij, luftëtarët shqiptarë i sprapsën forcat serbe në hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë e Drinit të Zi. Në zanafillën e shtetit të ri shqiptar, me shpalljen e Pavarësisë Kombëtare më 28 Nëntor 1912, Kuvendi i mbledhur në Vlorë në të cilin merrnin pjesë të gjitha viset shqiptare, në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Qeverisë së kryesuar nga Ismail Qemali, u zgjodh Mehmet Pashë Deralla, i cili për vetë rolin dhe peshën që përfaqësonte aso kohe në këto zhvillime, iu besua ky post nga më të rëndësishmit në atë kabinet qeverisës për vijimësinë e shtetit të sapoformuar shqiptar.

Në kushtet ku gjendej aso kohe shteti i sapo krijuar, shtrohej si një detyrë parësore konsolidimi i Shtabit të Përgjithshëm, i drejtuar nga Ali Shefqet Shkupi, dhe organizimi e mobilizimi i formacioneve luftarake, e në të njëjtën kohë lipsej të përgatitej terreni për hartimin dhe vënien në zbatim të një pakete të posaçme ligjore, rekrutimi i oficerëve profesionistë dhe të përkushtuar në drejtim të çështjeve kombëtare, të cilët më parë kishin shërbyer në ushtrinë perandorake, dhe në të njëjtën kohë të mos lejohej dezertimi i rezervistëve dhe të mos rrëmbeheshin armët prej tyre. Masat e shpejta që u morën për organizimin e ushtrisë, policisë, xhandarmërisë e në veçanti të milicisë më 3 Qershor 1912, padyshim që mbajnë mbi vete mendjen dhe kontributin e shquar të gjeneralit Mehmet Pashë Deralla. Falë përkushtimit dhe aftësive të tij drejtuese e organizative, ai afroi rreth vetes rreth 70 oficerë dhe 150 nënoficerë, që deri në atë kohë kishin shërbyer pranë ushtrinë turke dhe ishin të shkolluar, duke krijuar bërthamën rreth së cilës do të mblidheshin shqiptarë të devotshëm, për të qenë pjesë përbërëse e radhëve të Forcave të Armatosura dhe krijimin e ushtrisë së rregullt shqiptare.

Ndër figurat e para që iu përgjigjën thirrjes së parisë shqiptare dhe që ishin e u vunë nën komandën e Mehmet Pashë Derallës, ishin ushtarakë të njohur si: Ismail Haki Tatzati, Rexhep Shala, Mustafa Maksuti, Mustafa Aranitasi, Ali Fehmi Kosturi, Hysen Prishtina etj. Në

historiografinë shqiptare njihet si meritë kryesore e Mehmet Derallës, që mundi të organizojë Komandën e Përgjithshme dhe Shtabin Madhor, me strukturat përkatëse dhe në varësi të tyre strukturat në prefektura e nënprefektura, komuna e fshatra, duke u përcaktuar edhe përgjegjësitë lëndore e territoriale.

Me qëllim për t'iu përmbajtur fakteve dhe të vërtetave historike, Mehmet Deralla kur drejtonte në atë periudhë Ministrinë e Luftës, nuk nguroi të kontribuojë në hartimin e "Rregullores për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës", më 13 prill 1913 dhe "Rregullores së Qeverisë së përkohshme mbi formimin e Milicisë Shqiptare", më 3 qershor 1913. Duket se nga Qeveria Provizore e Shqipërisë, e veçanërisht nga gjenerali i Luftës, Mehmet Deralla, në atë kohë ishte vlerësuar si hap themelor organizimi i strukturës së milicisë shqiptare, të cilës iu dhanë kompetenca edhe për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike. Rregullorja "Milicia Shqiptare", i përcaktonte asaj misionin "për mbrojtjen e vendit deri sa të formohet ushtria e rregullt". Ajo, pra milicia, do të ishte një formacion i specializuar nën varësinë e Ministrit të Luftës, si strukturë ushtarake.

Sipas kësaj rregulloreje, "Çdo prefekturë do të konsiderohet si brigadë, ndërsa çdo nënprefekturë si batalion, kurse komunat si një kompani. Qytetet janë konsideruar kompani të veçanta, kurse fshatrat toga milicie. Kryetarët e tyre do të gradohen. Rekrutohen moshat 20-40 vjeç. Në secilën komandë të tyre do jetë edhe një regjistër për ngjarjet, si dhe një regjistër për statistikën vjetore mbi ngjarjet e ndryshme, të cilat do t'i raportohen Ministrisë së Luftës".

Është i rëndësishëm përcaktimi në rregullore për "Detashmentet shëtitës të Milicisë", ku theksohej se: "Art. 25, Deri sa t'arrijë në shkallën e mjaftueshme organizimi i ushtrisë së rregullt, i Policisë dhe i Xhandarmërisë, për të zënë vendin provizorisht të fuqisë s'armatosur brenda në kufi të sotshëm dhe në vende ku do të shihet nevoja, do të formohen detashmente shëtitës të Milicisë Ushtarake. Këto detashmente

veç se do të jenë nën urdhrin e komandantit të batalionit të atyre zonave ku ato janë shënuar të shërbejnë, ato do të jenë kurdoherë përkrahësit e Milicisë dhe të Xhandarmërisë për të siguruar qetësinë”.

“Dokumentet e kohës dëshmojnë për angazhimin dhe kontributin e jashtëzakonshëm të ministrit Deralla, i cili me shumë kujdes ndjek dhe analizon situatën e komplikuar dhe vëren në horizontin e kontinentit vazhdimin e konflikteve ndërkombëtare, prandaj merr masa për pozicionim sa më të mirë të shqiptarëve”<sup>385</sup>. Në momente të tilla, roli dhe vizioni i Mehmet Pashë Derallës, fiton përmasa universale, përtej aktualitetit ku jetoi dhe kontribuoi, duke mos mbetur thjesht në fizionominë e një patrioti dhe strategu luftarak, por edhe të një burri shteti, i cili me përkushtimin e tij u shndërrua në një faktor të rëndësishëm dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në formimin e shtetit shqiptar dhe vijimësinë e tij në përballje me sfidat që do të parashtronte ardhmëria.

## **Përfundim**

Në krejt korpusin e zhvillimeve për mëvetësi, studiuesit e shumtë që janë marrë me trajtimin e kësaj periudhe historike, bien në një mendje kur nënvizojnë faktin se Gjeneral Mehmet Deralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës së shqiptarëve përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin shpërbërjen e Shqipërisë si tërësi gjeografike dhe nocion nacional e kulturor. Zhvillimet politiko-

---

<sup>385</sup> Skënder Zogaj: Mehmet Pashë Deralla – gjenerali dhe ministri i parë i ushtrisë shqiptare. Mbajtur në tryezën për 100- vjetorin e Pavarsisë së Shqipërisë dhe 134- vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Zvicër, më dt.16.06.2012.

ushtarake në ditët e Shpalljes së Pavarësisë e më tej janë pasqyruar më gjerësisht në jetëshkrimin e Ismail Qemalit, por vlen të nxirret në pah fakti se pashai tetovar, me grupin e kosovarëve mori mbi vete rolin dhe misionin madhor, atë të mbrojtjes së qeverisë së parë të shtetit të ri shqiptar, duke mos pasur asnjë strukturë të mirëfilltë, përveç vullnetarëve dhe mbështetësve të tyre.

## **Bibliografi**

Baku, Pasho: Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Sh. B. Bacchus, Tiranë 2002, f. 800.

Bislimi, Myzafer: Shqiptarët dhe revolucioni xhonturk, studim, Instituti i Historisë Nacionale, Shkup, 2008. f. 265.

Jacques, Edvin: Shqiptarët - Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme, studim, Sh.B. Kartë e Pendë, Tiranë 1997, f. 785.

Shpuza, Gazmend: Në vazhdën e gjurmëve për epokën e Rilindjes Kombëtare, studim, Sh.B. Toena, Tiranë 1997, f. 3443.

Zogaj, Skënder: Mehmet Pashë Deralla – gjenerali dhe ministri i parë i ushtrisë shqiptare. Për: BISHZ-së, Tryeza për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë dhe 134-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Zvicër, Solothurn, Berntorstrasse 10, dt.16.06.2012.

Sinani, Arsim : Neoshqiptarizmi i Mehmet Pashë Derallës, Revista Diskutime, numri 11